



02Nr 5615/2022  
20.07.2022

Në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr.06/L-114, Kapitulli V-neni 67 dhe 68, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 nenit 5 pika c, Ligjit të Punës Nr.03/L-212 nenit 8, Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032 nenit 35, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2021, Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm Komuna Hani Elezit shpallë:

## KONKURS

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës)

Institucioni: Komuna Hani Elezit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për lëndën Gjuhë Shqipe (zëvendësim)

njësia/ sektori: në SHFMU" Kështjella e Diturisë" Paldenicë

Numri i pozitave : Një (1) pozitë me afat të caktuar

Koeficienti/Grada: A-421/1

Orët e punës: 20 orë në javë

### Kushtet e pjesmarrjes në rekrutim:

-Niveli master Gjuhë dhe letërsi shqipe - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);

-Sistemi katërvjeçar

- Niveli baçelor Gjuhë dhe letërsi shqipe - Fakulteti i Edukimit (katërvjeçar 240 ECTS);

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës , në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mesimdhënies;
- Të përgadit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mesimdhënies dhe vlersimit në përputhje me me Udhëzimet Kurikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlersimit të nxënësve.
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës;
- Të respektoj autoritetin e drejtpërdrejt të zyrtarit , të cilit i raporton dhe ti kryej detyrat që mund ti caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

### **Dokumentet e nevojshme:**

- Formulari i aplikimit (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
- Rezumeja personale (CV).
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë kopje).
- ~~Diploma e kualifikimit (ose certifikata) duhet të jene kopje të vërtetuara te noteri.~~
- ~~Certifikata që nuk jeni nën hetime nga gjykata.~~
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT-i, tjerat jo profesionale nuk shqyrtohen.

### **Afati dhe mënyra e aplikimit:**

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data 19.08.2022 deri 02.09.2022 (16:00).**

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>, të gjitha dokumentet siç kërkohen nga shpallja e konkurimit, kandidati përmes aplikacionit vetëdeklaror se janë të vërteta dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e tyre.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzohet çdo aplikacion i kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Mirëprehten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.



Kryetari i Komunës  
Mehmet Ballazhi